

Analizë e teksteve mësimore

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Analizë e teksteve mësimore
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i IV-t Semestri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Sadije Rexhepi
Të dhënat kontaktuese:	sadije.rexhepi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Tekstet mësimore janë medium themelor i mësimdhënies së gjuhës së huaj, pasi që ata i përmbajnë të gjitha çka nevojiten për nxënien e një gjuhe të huaj si mjet për komunikim. Njohja e teksteve mësimore të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj (DaF) është e domosdoshme për planifikimin e mësimdhënies. Në këtë lëndë do të analizohen disa nga DaF-tekstet mësimore të viteve të fundit. Do të diskutohet për përbërjen dhe ndërtimin e këtyre teksteve mësimore si dhe për rolin e kornizës së përbashkët evropiane për prodhimin e DaF-teksteve mësimore. Për t'i analizuar dhe vlerësuar këto tekste mësimore, duhet të jemi në gjendje që t'i njohim qasjet metodologjike më të shpeshta të mësimdhënies së gjuhës së huaj. Për këtë arsye, kjo lëndë i prekë këto pika kryesore: Analizë dhe kritikë e metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj si dhe analizë dhe kritikë e teksteve mësimore. Përveç kësaj në kuadër të kësaj lënde do të trajtohet edhe nxënia/mësimdhënia e leksikut, si një ndër fushat të cilat përfshihen në analizën/kritikën e teksteve mësimore.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimet kryesore të kësaj lënde janë që studentët:

- të njihet me përbërjen dhe ndërtimin e DaF-teksteve mësimore si dhe me rolin e kornizës së përbashkët evropiane për prodhimin e DaF-teksteve mësimore.
- të njihen me qasjet metodologjike më të shpeshta të mësimdhënies së gjuhës së huaj,
- të njihen me analizën dhe kritikën e metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj si dhe me analizën dhe kritikën e teksteve mësimore.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

njohin dhe analizojnë tekstet mësimore që përdoren më së shpeshti në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj;

dallojnë cili tekst mësimor është i përshtatshëm për mësimdhënien në nivelet e caktuara (nivele fillestar, të mesëm, të avancuar);

demonstrojnë njohuri për metodat e teknikat e didaktizimit të leksikut;

demonstrojnë njohuri për metoda të ndryshme të mësimdhënies

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15

Përgatitja për provimin final	4	2	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			85 orë: 25 = 3.4 3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, si dhe punimeve seminarike që i përgatisin studentët dhe i prezantojnë në klasë, si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.		
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit dhe detyrat individuale të kryera në klasë dhe në shtëpi 10%; Punimi i seminarit 60%; Prezantimi 30%.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rösler, Dietmar/ Würfel, Nicola. 2017. <i>Lernmaterialien und Medien 5</i>. Stuttgart. 2. Storch, Günther. 2009. <i>Deutsch als Fremdsprache. Eine Didaktik</i>. W. Fink. München. 3. Bimmel, Peter/ Kast, Bernd/ Neuner, Gerhard (2011): <i>Deutschunterricht planen NEU. Fernstudieneinheit 18. Fernstudienprojekt zur Fort- und Weiterbildung im Bereich Germanistik und Deutsch als Fremdsprache. Teilbereich Deutsch als Fremdsprache</i>. Langenscheidt. Kassel, München. https://www.pdfdrive.com/deutschunterricht-planen-neu-fernstudieneinheit-18-teil-1-d187867681.html https://www.pdfdrive.com/deutschunterricht-planen-neu-fernstudieneinheit-18-teil-2-e187870467.html 4. Krumm, Hans-Jürgen/ Fandrych, Christian/ Hufeisen, Britta/ Riemer, Claudia. 2010. <i>Deutsch als Fremd- und Zweitsprache. Ein internationales Handbuch</i>. Huebert & Co. GmbH & Co. KG. Göttingen. 5. Rösler, Dietmar. 2012. <i>Deutsch als Fremdsprache: Eine Einführung</i>. Springer-Verlag GmbH. Stuttgart. https://www.pdfdrive.com/deutsch-als-fremdsprache-eine-einf%C3%BChrung-e158131688.html?fbclid=IwAR0khBIO58hkgJ_EVNF87fdo4VMX-wCKaJlSjS-Vb6MUYGprCKJe4bSBSEs 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kast, Bernd/Neuner, Gerhard (Hrsg.). 1994. <i>Zur Analyse, Begutachtung und Entwicklung von Lehrwerken für den fremdsprachlichen Deutschunterricht</i>. 2. Lies, Sercu. 2000. <i>Acquiring Intercultural Communicative Competence from Textbooks</i>. Leuven University Press. 		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i silabusit
Java 2:	Bestandteile von Lehrwerken und ihre Funktionen
Java 3:	Das Sprachniveau eines Lehrwerks und die Zielgruppen von Lehrwerken
Java 4:	Kommunikation, Lernstrategien
Java 5:	Die sprachlichen Mittel, Wortschatz
Java 6:	Grammatik, Wortbildung, Phonetik und Orthographie
Java 7:	Textverstehen, Leseverstehen
Java 8:	Hörverstehen, Schreiben
Java 9:	Medien
Java 10:	Interaktion im Daf-Unterricht
Java 11:	Sozialformen des Unterrichts
Java 12:	Landeskunde im Daf-Unterricht
Java 13:	Prezantimet e seminareve
Java 14:	Prezantimet e seminareve
Java 15:	Prezantimet e seminareve

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Për të fituar të drejtën për të hyrë në teste dhe provim, studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike duhet të fikën (apo të jenë pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.